

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-015/13

**Prishtinë
25 qershor 2013**

Në çështjen juridike të:

D. R.,
Vrnjačka Banja
Serbi

Pala ankuese

si trashëgimtar ligjor i **M.R.**

Paraqitësi i kërkesës

kundër

A. M.
Vushtrri

Pala përgjegjëse në ankesë/Pala përgjegjëse në kërkesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/149/2012 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA41351, KPA41352, KPA41353 and KPA41354), të dates 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më XX qershor 2013, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e paraqitura nga D. R. më 8 shkurt 2013, dhe të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-015/13, GSK-KPA-A-016/13, GSK-KPA-A-017/13 dhe GSK-KPA-A-018/13, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-015/13.
- 2- Hedhen poshtë si të vonuara ankesat e paraqitura nga D. R. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/149/2012 të datës 19 prill 2012, për sa i përket lëndëve të regjistruar në AKP me numrat KPA41351, KPA41352, KPA41353 dhe KPA41354.
- 3- Obligohet pala ankuese që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 6 nëntor 2007, M. R. (këtej e tutje “paraqitësi i kërkesës”) duke vepruar si anëtar i familjes së D.R. ka paraqitur disa kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), të cilat janë objekt i këtij aktgjykimi dhe me anë të së cilave ai kërkon konfirmimin e pronësisë, kthimin në posedim dhe kompensimin për pronat. Ai ka sqaruar se pronat e kërkuara ishin humbur me 16 korrik 1999 dhe se humbja ishte rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë.

Të dhënat rreth ngastrave të kërkuara janë si në vijim:

Numri i ankesës dhe i dosjes së lëndës në AKP	Të dhënat rreth ngastrave
GSK-KPA-A-015/13 (KPA41351)	Ngastra numër 537/2, që gjendet në Vushtri, zona kadastrale e Reznikut, kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 2 ha 3 ari e 7 m ² ;

GSK-KPA-A-016/13 (KPA41352)	Ngastra numër 538, që gjendet në Vushtrri, zona kadastrale e Reznikut, kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 0 ha 20 ari e 5 m ² ;
GSK-KPA-A-017/13 (KPA41353)	Ngastra numër 540/3, që gjendet në Vushtrri, zona kadastrale e Reznikut, kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 0 ha 8 ari e 20 m ² ;
GSK-KPA-A-018/13 (KPA41354)	Ngastra numër 547, që gjendet në Vushtrri, zona kadastrale e Reznikut, kullosë e klasës 3, me sipërfaqe prej 0 ha 4 ari e 60 m ² ;

Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar këto dokumente në AKP:

- Fletën poseduese nr. 58, të lëshuar me 18 tetor 2007 nga Drejtorati për Kadastër dhe Pronë të Paluajtshme i Komunës së Vushtrrisë (ku ceken pronat e kërkuara në emër të bartëses të së drejtës pronësore D.R. – e ëma e paraqitësit të kërkesës);
- Certifikatën e lindjes së paraqitësit të kërkesës nr. 296, të lëshuar me 31 gush 1955;
- Certifikatën e vdekjes nr. 203-2/201 të bartëses të së drejtës pronësore (D. R.), të lëshuar me 19 korrik 2006;
- Deklaratën e paraqitësit të kërkesës të datës 29 prill 2009 (që thekson se pretendimet e palës përgjegjëse në kërkesë nuk janë të vërteta);
- Shënimet mbi kursimet nga “Jogobanka” në emër të paraqitësit të kërkesës; dhe letërnjoftimin e paraqitësit të kërkesës nr. 8569, të lëshuar me 17 shkurt 1983.

AKP-ja sipas detyrës zyrtare e ka gjetur Certifikatën e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme UL-70202054-00058, të lëshuar me 7 nëntor 2008 nga Zyra Komunale Kadastrale e Vushtrrisë, që tregon se bartësja e së drejtës pronësore – e ëma e paraqitësit të kërkesës ishte pronare e ngastrave të kërkuara. Po ashtu janë gjetur dhe verifikuar pozitivisht letërnjoftimet dhe certifikatat e paraqitura.

Më vonë në vitin 2009 dhe 2011, paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se pretendimet e palës përgjegjëse në kërkesë ndaj ngastrave të kërkuara nuk janë të vërtetat dhe se ai asnjë herë nuk ia kishte shitur pronat atij. Ai ka shtuar se i kishte shfrytëzuar rregullisht pronat e kërkuara derisa kishte përfunduar fushata e NATO-s. Paraqitësi i kërkesës gjithashtu ka deklaruar se pala përgjegjëse në kërkesë kishte filluar të shfrytëzonte pronat e kërkuara vetëm pas fushatës së lartpërmendur e jo me parë siç kishte pohuar që nga viti 1986.

Në të gjitha rastet, zyrtarët e AKP-së kishin shkuar në qershor të vitit 2008 në vendet ku supozohej se gjendeshin ngastrat nr. 537/2, 538, 540/3 dhe 547 dhe kishin vendosur nga një shenjë në çdo ngastër, ku njoftonin për kërkesën dhe informonin se çdokush që pretendonte të drejtë ligjore të ngastrës duhej të

lajmërohej dhe të merrte pjesë në procedurën pran AKP-së. Më vonë këto njoftime janë kontrolluar në bazë planit kadastral, ortofotos dhe koordinatave të GPS-it dhe janë gjetur që jenë të sakta.

Më 2 korrik 2008, pas marrjes së njoftimit të kërkesës, pala përgjegjëse në kërkesë ka nënshkruar kërkesën për të marrë pjesë në procedurë. Ai ka pretenduar të drejtën ligjore ndaj pronave të kërkuara.

Më 29 tetor 2008, në përgjigjen e tij në kërkesa, pala përgjegjëse në kërkesë ka deklaruar se i kishte blerë pronat e kontestueshme nga paraqitësi i kërkesës. Ai i ka propozuar AKP-së që të kërkoj nga paraqitësi i kërkesës librezën e “Jugobankës” të vitit 1986, duke shtuar se ai ia kishte paguar paraqitësit të kërkesës nëpërmjet kësaj banke në Mitrovicë shumën prej 12 milion dinarëve si pjesë e çmimit të blerjes në lidhje me njërin nga pronat e kërkuara, ndërsa e kishte paguar pjesën e mbetur prej 30 milion dinarëve – kjo fjali nuk është qartë. Përveç kësaj, ai ka kërkuar nga AKP-ja që të rishqyrtojë lëndën sa më parë që të jetë e mundur.

Për të mbështetur pretendimet e tij, pala përgjegjëse në kërkesë ka dorëzuar, ndër të tjera, këto dokumente në AKP:

- Fletën poseduese nr. 58, të lëshuar me 18 mars 1988 nga Drejtorati për Çështje Pronësore i Komunës së Vushtrrisë (ku ceken pronat e kërkuara në emër të bartëses të së drejtës pronësore);
- Vendimin nr. 133, të lëshuar me 2 korrik 1946 nga Komisioni për Rishikimin e Reformës Agrare (që tregon se të atit të paraqitësit të kërkesës – P. R., i është njohur e drejta mbi tokën që përbëhet nga dy ngastra);
- Vendimin nr. 466-22, të lëshuar me 18 mars 1988 nga Drejtorati për Çështje Pronësore i Komunës së Vushtrrisë (që i referohet uzurpimit të një pjese të ngastrës kadastrale nr. 530 nga paraqitësi i kërkesës);
- Vendimin nr. 466-28, të lëshuar me 18 mars 1988 nga Drejtorati për Çështje Pronësore i Komunës së Vushtrrisë (që i referohet uzurpimit të një pjese të ngastrës kadastrale nr. 654 nga paraqitësi i kërkesës);
- Autorizimin e datës 16 qershor 2008, të vërtetuar vetëm me vulën e avokatit (me anë të së cilit pala përgjegjëse në kërkesë e autorizonte avokatun e tij N. B. që të përfaqësojë interesat e tij pranë AKP-së);
- Kartelën identifikuese nr. 797/2003 në emër të përfaqësuesit të palës përgjegjëse në kërkesë, N.B., të lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës; dhe
- Letërnjoftimin nr. 2005198057, të lëshuar me 29 maj 2001 në emër të palës përgjegjëse në kërkesë.

Përveç kartelave identifikuese të cilat janë verifikuar pozitivisht, AKP-ja ka konsideruar si të panevojshëm verifikimin e dokumenteve tjera të lartpërmendura.

Më 20 tetor 2008, pala përgjegjëse në kërkesë kishte deklaruar si vijon “ [.....] gjatë periudhës ndërmjet qershorit dhe korrikut të vitit 1986, nuk më kujtohet data e saktë, së bashku me vëllain tim Rr. i kemi blerë pronat e paluajtshme [ngastra e kërkuara – që janë çështje lëndore e kërkesave me numrat KPA41351, KPA41352, KPA41353 dhe KPA41354] të D. R. ish nga Rezniku. [.....] ajo na ka njoftuar se po e shiste pronën e paluajtshme në fjalë, [.....]. Vëllai im dhe unë kemi shkuar në shtëpinë e saj dhe ne po ashtu kemi qenë të shoqëruar nga fqinji ynë Sh. C. nga Rezniku. [.....] D. ishte së bashku më të birin M. R. dhe në bisedë e sipër ajo na ka ofruar çmimin për pronën e paluajtshme për të cilin thanë se ishte rreth 4. 00. 00 ba. Ne u pajtuam që këtë pronë të paluajtshme ta blinim për shumën prej 150,000.00 dinarëve. Po atë ditë kam paguar shumën prej 30,000.00 dinarëve në para të gatshme ndërsa për pjesën tjetër jemi pajtuar që ta paguajmë në vjeshtë të vitit 1986. Shumën prej 120,000.00 dinarëve ia kam paguar të birit të D., z. M.R. në vjeshtë të vitit 1986 nëpërmjet Jugobankës in Mitrovica të cilën ai pastaj e ka transferuar në kartelën e tij të Jugobankës. [.....] M. R. më ka thënë se do ta barte të drejtën mbi pronën e paluajtshme në emrin tonë sapo kjo të ishte e mundur sepse në atë kohë shteti e kishte ndaluar shitblerjen e pronës së paluajtshme që iu përkiste serbëve dhe kjo kishte qenë arsyeja se përse prona e paluajtshme nuk ishte bartë në emrin tim [.....]”.

Më 15 nëntor 2010, pala përgjegjëse në kërkesë edhe një herë ka përsëritur pretendimet e tij se i kishte blerë ngastrat e kërkuara nr. 537/1 (që është çështje lëndore e kërkesës KPA41350), 537/2 (svKPA41351), 538 (që është çështje lëndore e kërkesës KPA41352), 547 (që është çështje lëndore e kërkesës KPA41354) dhe 540/3 – pjesën e ngastrës nr. 540 (që është çështje lëndore e kërkesës KPA41353). Ai në fund ka shtuar se i kishte në posedim dhe shfrytëzim këto ngastra që nga koha kur i kishte blerë ato.

Më 22 nëntor 2011, AKP-ja ka kërkuar nga përfaqësuesi i palës përgjegjëse në kërkesë (N. B.) që t'i paraqes dokumentet të cilat dëshmojnë se pala përgjegjëse në kërkesë, A. M., i kishte blerë ngastrat e kërkuara nga e ëma e paraqitësit të kërkesës, D. R.. Ai është përgjigjur se pala përgjegjëse në kërkesë nuk ka dokumente pasi që nuk ekziston ndonjë kontratë e lidhur në atë kohë, duke theksuar se pala përgjegjëse në kërkesë vetëm ia kishte dhënë paraqitësit të kërkesës çmimin e blerjes nëpërmjet “Jugobankës”. Ai ka shtuar se e kishin gjetur një vendim të vitit 1945 i cili tregon se pronat e kërkuara gjatë zbatimit të reformës agrare ishin marrë nga familja e palës përgjegjëse në kërkesë dhe i ishin dhënë në mënyrë të paligjshme familjes së paraqitësit të kërkesës. Për më tepër, ai ka pohuar se në vitin 1986, pala përgjegjëse në kërkesë i kishte blerë pronat e kërkuara nga e ëma e paraqitësit të kërkesës, pasi që këto prona më parë i përkisnin familjes së tij (palës përgjegjëse në kërkesë). Në fund, ai ka deklaruar se pala përgjegjëse në kërkesë nuk ka prova tjera për të paraqitur, përveç një dëshmitari i cili mund të dëshmojë atë transaksion.

Më 29 shkurt 2012, gjatë seancës së tij të 27, Komisioni kishte urdhëruar një dëgjim verbal lidhur me kërkesat e lartpërmendura nga njëri prej anëtarëve të tij në përputhje me nenin 5.4 të Shtojcës III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Të dy palët dhe dëshmitarët e palës përgjegjëse në kërkesë ishin ftuar që të merrnin pjesë në dëgjimin e mbajtur me 29 mars 2012 në AKP. Në kuadër të këtij dëgjimi, pala përgjegjëse në kërkesë përsëri (sikurse në deklaratat e mëhershme) ka përsëritur se ai dhe vëllai i tij H. M. i kishin blerët pronat e kërkuara nga e ëma e paraqitësit të kërkesës në vitin 1985 me çmimin e blerjes prej 150 milion dinarë. Ai ka shtuar se ai dhe vëllai i tij e kishin paguar çmimin e blerjes me dy këste. Gjatë dëgjimit të përfaqësuesit të palës përgjegjëse në kërkesë, N. B., dhe të dy dëshmitarëve të propozuar nga ky i pari, të pranishëm ishin edhe Sh. C. dhe I. M.

Pasi që paraqitësi i kërkesës nuk ka qenë në gjendje të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore në Prishtinë më 3 prill 2013, një seancë tjetër është organizuar në Mitrovicë dhe paraqitësi i kërkesës ka marrë pjesë në të. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se ai nuk është i interesuar që të ndjekë kërkesat KPA41351, KPA41352, KPA41353 dhe KPA41354, por është i interesuar në një ngastër tjetër e cila është çështje lëndore e kërkesës KPA41350 (e cila ishte vendosur me një vendim tjetër të Komisionit, KKPK/D/A/148/2012 – jo me vendimin e kundërshtuar.

Me vendimin e tij KKPK/D/A/149/2012 të datës 19 prill 2012, KKPK-ja i ka refuzuar kërkesat KPA41351, KPA41352, KPA41353 dhe KPA41354. Paraqitësi i kërkesës, i cili i ka përshkruar ngastrat kontestuese sipas kulturës, sipërfaqes dhe numrit të ngastrës, nuk ka dëshmuar pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronat e kërkuara menjëherë apo gjatë konfliktit të viteve 1998-99.

Sipas çertifikatës së prezentuar të vdekjes paraqitësi i kërkesës kishte vdekur me 26 Nëntor 2012. Vendimi i është dorëzuar pasardhësit të tij, djalit të tij D.R. me 21 dhjetor 2012. Me datë 8 shkurt 2013 D. R. ka paraqitur ankesë kundër këtij vendimi, ku ka kërkuar nga Gjykatat Supreme që të pranojnë ankesën e tij dhe të rishikojë vendimin e kundërshtuar të Komisionit duke pranuar kërkesat dhe duke vendosur që ai është pronar i pronave të paluajtshme, apo të hedhë poshtë vendimin e kundërshtuar edhe ta kthejë lëndën për rigjykim tek organi i shkallës së parë.

Vendim i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë më 4 dhjetor 2012. Më 9 janar 2013, pala përgjegjëse në kërkesë ka dorëzuar një parashtresë tjetër me emrin “argumentet shtesë” e titulluar në letrën përcjellëse të AKP-së si “ankesë me shkrim”. Në pjesën e parë të dokumenteve ai ka përsëritur të njëjtat pretendime sikurse në deklaratat e mëhershme. Në pjesën e dytë ai i është referohet ngastrës nr. 537/1 e cila është çështje lëndore e kërkesës me numër KPA41350 (dhe nuk është objekt i shqyrtimit të këtij aktgjykimi).

Gjykata Supreme i ka bashkuar lëndët.

Arsyetim ligjor:

Bashkimi i ankesave:

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për Zgjidhjen e kërkesave lidhur pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale parasheh se Gjykata Supreme mund të vendos të bashkojë apo shkrijë ankesat kur një bashkim apo shkrirje e tillë autorizohet nga Komisioni në përputhje me nenin 1.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen ia mundëson Komisionit që të bashkojë apo shkrijë kërkesat me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje ligjore dhe prova të përbashkëta.

Dispozitat e Ligjit për Procedurën Civile, të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Suprem në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 për Procedurën Kontestimore, parashohin mundësinë e bashkimit të të gjitha ankesave me anë të një aktvendimi të gjykatës nëse një bashkim i tillë i kontribuon efikasitetit të procedurës.

Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme gjen se përveç një numri të ndryshëm të lëndës për të cilën pikërisht është paraqitur ankesa përkatëse, e gjithë baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave, janë krejtësisht të njëjta në të gjitha 4 (katër) rastet. Vetëm ngastrat që janë objekt i së drejtës pronësore, e të cilat kërkohen në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në të njëjtën deklaratë sqaruese dhe në të njëjtat dokumente. Për më tepër, arsyetimi ligjor i dhënë nga Komisioni lidhur me kërkesat është i njëjtë.

Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-015/13 deri në GSK-KPA-A-018/13 bashkohen në një lëndët të vetme me numër GSK-KPA-A-015/13.

Pranueshmëria e ankesave:

Gjykata Supreme e Kosovës e ka shqyrtuar aktgjykimin e kundërshtuar në përputhje me nenin 194 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të dosjeve të lëndëve dhe pretendimeve ankimore ka gjetur si në vijim:

Ankesat janë të papranueshme sepse ato janë paraqitur pas afatit ligjor në përputhje me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, i cili parasheh se pala mund të paraqes ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i vendimit. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese

Dragiša Radeč më 21 dhjetor 2012. Ai i ka paraqitur ankesat më 8 shkurt 2013. Afati ligjor për paraqitjen e ankesës ishte 21 janar 2013 (e hënë). Në këtë rast ankesat janë ushtruar pas kësaj date – me 5 shkurt 2013, që d.m.th ato janë ushtruar pas afatit kohor të paraparë. Prandaj, në përputhje me nenin 196 të LPK-së, pasi që ankesat ishin paraqitur pas afatit ligjor, ato duhet të hedhen poshtë.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese/paraqitësi i kërkesës që – i ka paraqitur ankesat pas afatit të paraparë ligjor. Humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 90 ditësh. Neni 47.3 të këtij Ligji parashikon që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet përmbarimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it